



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i dosjes: KSC-BC-2020-06

Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit

Vendos: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Date: 9 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për autorizim të pjesëmarrjes përmes videolidhjes

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Dejvid Huper

Mbrojtësit të Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësit kujdestar të Rexhep Selimit
Robert Karls

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të neneve 21(4)(e) dhe (5), dhe 39(4) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 87(6) dhe 92(1) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën e rishikuar të parashtruar nga Prokurori i Specializuar,² lëshoi fletarrestimin për Kadri Veselin (“z.Veseli” ose “i akuzuari”)³ dhe urdhëroi transferimin e tij në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (“DHS”).⁴

2. Më 5 nëntor 2020, z. Veseli u arrestua⁵ dhe u transferua në objektin e paraburgimit të DHS-së në Hagë, Holandë.⁶ Më të njëjtën ditë, Administratorja caktoi z. Ben Emerson mbrojtës të z. Veseli.⁷

3. Më 6 nëntor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendosi të mbajë seancën e paraqitjes së parë të z. Veselit të martën, më 10 nëntor 2020, në orën 15:00.⁸

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi konfirmimin e aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2020-06, F00027/A03/RED Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version publik i redaktuar i fletarrestimit kundër Kadri Veselit*, 5 nëntor 2020, publik.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00027/A04/RED Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version publik i redaktuar i urdhrit për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 5 nëntor 2020, publik.

⁵ KSC-BC-2020-06, F00050, Administratorja, *Njoftim i arrestimit të Kadri Veselit sipas rregullës 55(4)*, 5 nëntor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00054, Administratorja, *Njoftim i pranimit të Kadri Veselit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe caktim të mbrojtësit (“Njoftim”)*, 5 nëntor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me shtojcat 1 dhe 2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁷ Njoftim, paragrafi 6.

⁸ KSC-BC-2020-06, F00060, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për caktimin e datës së paraqitjes së parë dhe çështjeve të lidhura me të*, 6 nëntor 2020, publik, paragrafi 20(a).

4. Më 9 nëntor 2020, mbrojtësi për z. Veseli parashtroi kërkesën për të marrë pjesë në paraqitjen e parë përmes videolidhjes, për shkak të gjendjes shëndetësore të mbrojtësit si dhe për shkak se kufizimet e udhëtimeve në lidhje me COVID-19 në fuqi aktualisht në Mbretërinë e Bashkuar, nuk e lejojnë mbrojtësin të jetë fizikisht i pranishëm në seancën e paraqitjes së parë, të planifikuar.⁹

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Në bazë të nenit 39(4) të Ligjit, në zbatim të urdhërarrestimit ose fletarrestimit të lëshuar nga Dhomat e Specializuara, personi kundër të cilit është konfirmuar aktakuza merret në ndalim, menjëherë informohet për akuzat kundër tij ose saj dhe transferohet në Dhomat e Specializuara.

6. Sipas rregullave 87(6) dhe 92(1) të Rregullores, i akuzuari nxirret para Gjykatësit të Procedurës Paraprake pa vonesë të papërligjur për paraqitjen e tij ose të saj të parë.

7. Në bazë të neneve 21(4)(e) dhe (5) të Ligjit, i akuzuari ka të drejtën të zgjedhë mbrojtësin e vet dhe përfaqësimi ligjor është i obligueshëm në rast se i akuzuari është në paraburgim.

III. DISKUTIM

8. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se, për shkak të gjendjes shëndetësore të mbrojtësit dhe kufizimeve në udhëtim në lidhje me COVID-19, z. Emerson nuk mund të jetë fizikisht i pranishëm në selinë e DHSK-së në paraqitjen e parë të afërme të akuzuarit. Rrjedhimisht, autorizimi i mbrojtësit për të marrë pjesë në seancë përmes videolidhjes është i domosdoshëm për të garantuar të drejtën e z. Veseli për mbrojtës si dhe të drejtën e tij që të nxirret para Gjykatësit të Procedurës Paraprake pa vonesë të papërligjur.

⁹ KSC-BC-2020-06, F00068, Mbrojtja për z. Veseli, *Kërkesë urgjente për një urdhër për lejim të pjesëmarrjes të mbrojtësit të specializuar në paraqitjen e parë në distancë përmes videolidhjes ("Kërkesa")*, 9 nëntor 2020, publike, paragrafët 5-6.

9. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se procedimet përmes videolidhjes rregullohen në bazë të Udhëzuesit të Punës së Administratores për videolidhjet (KSC-BD-23/KORRIGJUAR) dhe në të ardhmen çdo kërkesë e tillë nga palët i parashtrohet drejtpërsëdrejti Administratores, në përputhje me nenet 2-5 të Udhëzuesit të Punës përkatës dhe mjaftueshëm në kohë në mënyrë që Administratorja të ndërmarrë hapat e duhur dhe të informojë Gjykatësin e Procedurës Paraprake.

IV. VENDIM

10. Për arsyt e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **MIRATON** kërkesën dhe **AUTORIZON** mbrojtësin për z. Veseli që të marrë pjesë në paraqitjen e parë të martën, 10 nëntor 2020, në orën 15:00, përmes videolidhjes; dhe
- b) **URDHËRON** Administratoren të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për organizimin e videolidhjes në koordinim me mbrojtësin e z. Veseli.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E hënë, 9 nëntor 2020
Në Hagë, Holandë.